



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Operator Teknik për përdorimin e Pajisjes Elektronike të Identifikimit të zgjedhësve (PEI), për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himar, 4 Gusht 2024.**

Për t'u përzgjedhur si operator teknik nga KQZ, duhet të plotësosh kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

1. Gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
2. Nuk je i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen me dashje të një vepre penale;
3. Ke (të paktën) arsim të mesëm;
4. Nuk ke qenë anëtar i komisioneve zgjedhore dhe të grupeve të numërimit në dy proceset e fundit zgjedhore;
5. Nuk je anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike, të paktën në 3 vitet e fundit;
6. Nuk ke qenë i përfshirë publikisht në veprimtari politike për llogari të një subjekti zgjedhor në 5 vitet e fundit;
7. Ke njohuri dhe aftësi minimale të përdorimit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, si kompjuter, smartphone, tablet, etj.;
8. Je i gatshëm për të punuar edhe larg vendbanimit tënd;
9. Je me vendbanim në territorin e Bashkisë ku ndodhet qendra e votimit, ku do të caktohesh si operator nga KQZ;
10. Nuk je ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Ministrisë së Brendshme, i Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe shërbimeve të tjera me objekt veprimtarie të ngjashme me sa më sipër;
11. Nuk ndodhesh në kushtet e konfliktit të interesit;
12. Nuk je në marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë ose marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që kandidon në zonën zgjedhore ku ndodhet qendra e votimit në të cilën je caktuar si operator teknik.

**Detyrat e Operatorit të PEI:**

- Të përdorë Pajisjen Elektronike të Identifikimit të zgjedhësve në një qendër votimi në ditën e zgjedhjeve për kryetar bashkie të Himarës, 4 Gusht 2024, sipas udhëzimeve të KQZ.
- Të vendosë në funksionim kamerën vëzhguese në qendrën e votimit sipas udhëzimeve të KQZ.
- **Masa e shpërblimit:** 15,000 Lekë (bruto).

*Shënim: Ky pozicion pune përjashton çdo përfshirje në procedurat dhe veprimet e Komisionit të Qendrës së Votimit.*

Aplikuesi do të përzgjidhet sipas Bashkisë ku ka vendbanimin dhe do të trajnohet nga trajnues të kualifikuar.

Vlerësoje këtë mundësi punësimi edhe si kontribut qytetar për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të datës **4 Gusht 2024!**

**Afati i aplikimit:** 28 Korrik 2024

**Nxito të aplikosh! Koha dhe vendet janë të kufizuara!**